



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Njoftim për shtyp

(11 Dhjetor 2007)

Mbi autorizimin e përqendrimit të Bankës Amerikane të Shqipërisë me Bankën Italo-Shqiptare.

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 11 dhjetor 2007, miratoi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të Bankës Amerikane të Shqipërisë dhe Bankës Italo Shqiptare.

BAA dhe BIA ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, të licencuar nga Banka e Shqipërisë. Këto shoqëri kanë lidhur një marrëveshje me 6 Nëntor 2007, e cila konsiston në bashkimin e Bankës Italo Shqiptare me Bankën Amerikane të Shqipërisë.

Transaksioni konsiston në bashkimin, sipas procedurës së përthithjes së BIA-s nga BAA-ja. Në përfundim të këtij transaksioni, krijohet banka e re BAA (nuk ndryshon emrin) dhe BIA pushon së ekzistuari si person juridik dhe të gjitha asetet, detyrimet, si dhe të gjitha marrëveshjet e marrëdhëniet ku BIA është palë, do transferohen sipas ligjit tek BAA.

Megjithëse ky përqendrim sjell ndryshime në strukturën e tregut bankar, duke ulur numrin e konkurrentëve (nga 17 në 16 banka) dhe duke forcuar pozicionin në treg të bankës së re BAA, nuk kufizohet konkurrenca në treg. Futja e shërbimeve/produkteve të reja, përmirësimi i atyre ekzistuese, nga ulja e shpenzimeve dhe rritja e të ardhurave, zhvillimi i teknologjive të informacionit, etj., janë tregues pro-konkurrues që tejkalojnë pasojat që rrjedhin nga forcimi i pozicionit në treg të BAA-së

Për këto arsye në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit të Bankës Amerikane të Shqipërisë me Bankën Italo Shqiptare.